

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

- I. Seminari i të premtës
- II. Punët kërkimore të sapo përfunduara
- III. Artikuj dhe materiale diskutimi në proces
- IV. Artikuj, intervista, fjalë të drejtuesve e punonjësve të Bankës, të botuara në shtypin e përditshëm
- V. Të ndryshme

I. SEMINARI I TË PREMTES

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2010, në serinë e "Seminareve të së Premtes", janë prezantuar shtatë punime nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, nga banka të tjera qendrore si dhe të sferës akademike. Materialet e prezantuara trajtuan çështje të stabilitetit monetar dhe financiar, të kursit të këmbimit, të politikave të zhvillimit, etj. .

"Seminari i së Premtes" për vitin 2010 u hap me një punim të Oriela Kodrës, nga Departamenti i Kërkimeve me temë "Indekset e Kushteve Monetare dhe Financiare; Rasti i Shqipërisë". Ky material ka për qëllim vlerësimin e peshave relative të normave reale të interesit dhe të kursit real të këmbimit në rastin e Shqipërisë, si dhe llogaritjen e indeksit të kushteve monetare dhe financiare. Për herë të parë indeksi i kushteve monetare (IKM) është përdorur nga Banka Qendrore e Kanadasë, duke shërbyer më pas si mekanizëm për drejtimin e politikës monetare dhe efektet e saj në ekonomi, i përdorur nga mjaft banka dhe institucione të tjera ndërkombëtare. IKM shprehet si një

mesatare e ponderuar e normave reale të interesit dhe kursit real të këmbimit që përcakton nëse kushtet monetare të një ekonomie të caktuar janë "të lehtësuara" apo "të shtrënguara", duke përmbledhur në një shifër të vetme presionin e ushtruar nga politika monetare mbi ekonominë, e si rrjedhojë mbi inflacionin. Metodologjia e përdorur për të vlerësuar peshat relative të normës reale të interesit dhe kursit të këmbimit është MZKV-ja (metoda e zakonshme e katrorëve më të vegjël), periudha e vlerësimit është 1998-2008 dhe të dhënat janë tremujore. Bazuar në rezultatet empirike rezulton që IKM për rastin e Shqipërisë është 3.8, që do të thotë se efekti i një vlerësimi me 3,8 pikë përqindje i kursit real të këmbimit (REER), mund të neutralizohet me 1 pikë përqindje rritje në normën e interesit.

Një tjetër prezantim i mbajtur në këtë seminar ishte ai me temë "Një shqyrtim mbi efektet e luhatshmërisë së kursit të këmbimit në eksportet e Azisë Lindore", nga Dr. Dilara Tas, Universiteti i Southern Illinois. Qëllimi kryesor i këtij materiali është vlerësimi i efektit afatgjatë të

luhatshmërisë së kursit të këmbimit në flukset e tregtisë së vendeve të Azisë Jug-Lindore, për periudhën para dhe pas vitit 1997. Materiali gjithashtu përqendrohet në vlerësimin e qëndrueshmërisë së efektit të kursit të këmbimit mbi flukset e eksporteve, bazuar në matje të ndryshme të luhatshmërisë. Autorja ka përdorur modelet ARCH(1) dhe GARCH(1,1) për vlerësimet e mësipërme. Rezultatet empirike treguan që kërkesa afatgjatë për eksporte varet nga çmimet e tyre relative, nga të ardhurat botërore, nga luhatshmëria e kursit të këmbimit dhe nga kursi real efektiv i këmbimit. Për vendet si Koreja dhe Malajzia, vihet re një lidhje negative midis luhatshmërisë së kursit të këmbimit dhe kërkesës për eksporte gjatë periudhave afatgjata. Kjo tregon se prodhuesit që nuk janë të prirur të rrezikojnë, preferojnë që transaksionet të kryhen brenda vendit, jo në tregjet ndërkombëtare.

“Ekuilibri i kursit real të këmbimit të lekut ndaj euros: Sa larg ekuilibrit është?”, punuar nga Erjon Luçi, Banka Botërore dhe Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, është materiali i radhës i prezantuar në serinë e “Seminareve të së Premtes”. Studimi ka për qëllim të identifikojë faktorët përcaktues në zhvillimet e kursit të këmbimit, të caktojë një kurs ekuilibër dhe të vlerësojë nëse kursi aktual i këmbimit është i zhvendosur ndaj atij ekuilibër. Përcaktuesit e kursit ekuilibër të konsideruar në këtë studim përfshijnë: diferencën e produktivitetit, mjetet e huaja neto, shpenzimet e qeverisë, diferencën e normave të interesit, shkallën e hapjes së ekonomisë, remitancat dhe kushtet e tregtisë. Metodologjia e përdorur është ARDL (Autoregressive Distributed Lag), zhvilluar nga Pesaran dhe Shin (1999). Autorët konkludojnë se kursi real i

këmbimit nuk duket të jetë shmangur në mënyrë të konsiderueshme nga ekuilibri afatmesëm.

Një tjetër material i prezantuar në serinë e “Seminareve të së Premtes” është ai me temë “Përdorimi i euros në Europën Qendrore, Lindore dhe Juglindore- Përhapja, shkaqet dhe ndikimi i krizës financiare botërore” nga Doris Ritzberger-Gruenwald (Drejtoreshë e Sektorit të Kërkimeve të Huaja, Banka e Austrisë), Helmut Stix (Ekonomist, Sektori i Studimeve Ekonomike, Banka e Austrisë), si dhe nga Thomas Scheiber (Ekonomist, Sektori i Kërkimeve të Huaja, Banka e Austrisë). Materiali prezanton rezultatet e mara nga pyetësi i drejtuar shtetësave të 10 vendeve europiane, pesë prej të cilave, anëtare të BE-së dhe pesë të tjerat, vende candidate për të hyrë në BE. Çështjet kryesore të shqyrtuara nga pyetësi kanë të bëjnë me mbajtjen e monedhës së huaj në formë cash, numrin e depozitave në monedhë të huaj, sasinë e kredisë së lëvruar në monedhë të huaj, etj. . Përfundimet e pyetësorit nxjerrin në pah euroizimin e lartë të disa vendeve. Kështu, ato vuajnë nga persistencë e lartë e shkallës së euroizimit dhe kriza financiare globale pati efekt në portofolin e çdo individi.

Material tjetër i prezantuar është ai me temë “Modeli institucional i zhvillimit socio-ekonomik: Roli i edukimit dhe trajnimit”, nga Oliver Deasy, përfaqësues i EU CARD në Shqipëri. Qëllimi i këtij prezantimi ishte njohja me modelin institucional të zhvillimit ekonomik, ku si rast i veçantë u trajtua ai i Irlandës. Rezultatet treguan që roli i edukimit dhe i trajnimit të individëve është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe ndikon në tërheqjen e IHD-ve (investimeve të huaja direkte). Është detyrë e të gjithëve që, kryesisht përmes

politikave për zhvillimin e strategjive, të nxisin edukimin dhe trajnimin e publikut.

Krishna Kamath, ekonomist në Departamentin e Financës pranë Wharton School of Business, SHBA, prezantoi materialin me temë “Match – Making and Rent – Seeking: An empirical analysis of mergers of Venture – Backed Companies”. Ky studim analizon sjelljen qira-kërkuese që shoqëron efektin “keiretsu” të sipërmarrjes kapitaliste. Duke përdorur shembujt e 750 shkrirjeve mes kompanive të mbështetura në kapitalin sipërmarrës, autori arrin në përfundimin që marrëveshjet ku kompania blerëse dhe kompania e synuar janë të mbështetura nga një investitor sipërmarrës i përbashkët, sjellin fitime aksionesh më të ulëta dhe performancë operationale më të keqe për kompaninë blerëse. Gjithashtu, blerësit e mbështetur në kapitalin sipërmarrës paguajnë më shumë për blerjen e kompanive që kanë të njëjtin sipërmarrës kapitalist. Në fundmi, aksionet (si mjet pagese) përdoren më shumë në shkrirjet e kompanive që kanë të njëjtin sipërmarrës kapitalist. Rezultatet e këtij studimi tregojnë që sipërmarrësit kapitalistë, duke ulur asimetrinë e informacionit, e lehtësojnë çiftimin e kompanive që shkrihen me njëra tjetrën dhe përdorin influencën e tyre për të nxjerrë fitime nga aksionerët e kompanisë blerëse.

Materiali përmblyës i serive të “Seminarit të së Premtes” për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 është ai me temë “Kredit Bankar dhe PBB”, nga Arjan Kadareja, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ky material ka si qëllim identifikimin e rëndësisë së kreditit bankar në transmetimin e politikës monetare në zonën euro, si dhe efektet reale që pësuan bankat nga kriza globale financiare në vitin 2007. Metoda e përdorur për vlerësimin e elementëve të mësipërm është metoda “Panel i Instrumentalizuar”, të dhënat janë tremujore dhe mbulojnë periudhën 1999-2008. Vendet e marra në studim janë: Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Holanda, Portugalia dhe Spanja. Rezultatet e këtij studimi tregojnë që në zonën euro, kanali i kreditimit bankar si kanal i transmetimit të politikës monetare është i rëndësishëm, kështu që ndryshimet në kreditin bankar (në volum dhe/apo standarde) kanë efekte të rëndësishme në PBB, ndryshe nga rasti i SHBA (Driscoll, 2004). Ky përfundim sugjeron përdorimin e zhvillimeve të kreditit bankar në politikbërjen monetare për zonën euro. Rezultatet e këtij studimi mund të përdoren për të matur efektet reale të goditjes negative që pësuan bankat gjatë krizës financiare të mesvitit 2007.

II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

1. “VLERËSIMI I PESHAVE PËR INDEKSIN E KUSHTEVE MONETARE NË SHQIPËRI” - NGA ORIELA KODRA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Materiali ka si qëllim vlerësimin e peshave relative të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit për rastin e

Shqipërisë. Studimi i mëparshëm i raportit të IKM-së është kryer nëpërmjet një metode kalibrimit të bazuar tek FMN (2004). Ky material synon të vlerësojë raportin e dy kanaleve kryesore të transmetimit të politikës monetare, normave të interesit dhe kursit të këmbimit, nëpërmjet një vlerësimi MZKV.

2. "ZHVILLIMI FINANCIAR DHE INFLACIONI NË SHQIPËRI" - NGA VASILIKA KOTA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Materiali vlerëson lidhjen midis inflacionit dhe zhvillimit financiar në Shqipëri. Përgjithësisht, studimet kanë treguar se kjo lidhje nuk është lineare. Normalisht, rritja e inflacionit ka një ndikim të ulët pozitiv, kur normat fillestare të inflacionit janë të ulëta dhe negativ, nëse ato janë të larta. Ky material synon të testojë nëse kjo hipotezë qëndron për rastin e Shqipërisë, duke studiuar lidhjen midis inflacionit dhe depërtimit financiar, me anë të kontrollit mbi tregues të tillë si: PBB-ja për frymë, hapja e vendit ndaj tregtisë dhe pjesa e konsumit publik ndaj PBB-së.

3. "VLERËSIMI AFATSHKURTËR I PBB-SË REALE"-NGA ARMELA MANÇELLARI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Qëllimi i këtij materiali është ndërtimi i modeleve për parashikimin afatshkurtër

të vlerës së PBB-së së vendit, për tremujorin aktual. Për një vendimmarrje të mirinformuar nevojitet vlerësimi i situatës aktuale ekonomike me disa mënyra dhe projeksionet afatshkurtra mbi ecurinë e ekonomisë reale. Duke qenë se të dhënat mbi PBB-në tremujore në Shqipëri publikohen me 12 javë vonesë, lind nevoja për parashikimin e ecurisë së këtij treguesi, para se ai të publikohet. Ky material përdor të dhëna nga shitjet reale, shitja dhe riparimi i automjeteve dhe nga komponentët e indekseve të besimit, për të parashikuar PBB-në e tremujorit aktual duke përdorur modele ekonometrike.

4. "NIVELI I REZERVËS OPTIMALE: RASTI I SHQIPËRISË" - NGA GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Qëllimi i këtij materiali është të prezantojë një model empirik lidhur me nivelin optimal të rezervave ndërkombëtare për një ekonomi të vogël, të hapur si Shqipëria, duke marrë parasysh goditjet e ndryshme ekzogjene që mund të pësojë ambienti makroekonomik.

III. ARTIKUJ DHE MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

Në këtë periudhë, puna kërkimore në Bankën e Shqipërisë është fokusuar në temat e mëposhtme:

1. "MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT BE – SHQIPËRI"-NGA ALBAN PLLAHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material analizon marrëdhëniet bilaterale të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Në

fokus të këtij materiali është Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, e veçanërisht, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me vendet e rajonit, rezultatet e shkëmbimeve tregtare ndërmjet palëve, si dhe aplikimi i "gravity model", i cili prodhon të dhëna parashikuese që mundësojnë krahasimin e volumeve tregtare aktuale, me ato potenciale.

1 Modeli aplikohet për tre nga partnerët kryesorë tregëtarë pjesë e BE-së (Greqi, Gjermani, Itali) si dhe për katër nga partnerët kryesorë rajonalë (Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Serbinë dhe Maqedoninë).

Rezultatet e modelit sugjerojnë se volumet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të BE-së, si Greqia dhe Italia, janë pranë ekuilibrit potencial të mundshëm, ndërsa ekziston hapësira për intensifikim të shkëmbimeve tregtare me Gjermaninë. Rezultatet e modelit për shkëmbimet tregtare me vendet e rajonit sugjerojnë se volumet tregtare me këto vende janë shumë më poshtë ekuilibrit potencial. Një mundësi e mirë për intensifikimin e shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit është përmirësimi i rrjetit infrastrukturor. Kështu, me anë të aplikimit të plotë të MSA-së, volumet tregtare do të intensifikohen ndjeshëm jo vetëm me partnerët tregtarë tradicionalë, por edhe me vendet e tjera të BE-së.

2. " QËNDRUESHMËRIA E POLITIKËS FISKALE: RASTI I SHQIPËRISË" - NGA GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Materiali ka për qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së politikës fiskale në Shqipëri, sipas përqasjes së zhvilluar nga Taylor (2002). Fokusi kryesor do i kushtohet testeve diagnostike jolineare dhe modeleve jolineare (STAR). Rezultatet e marra shërbejnë si material referues në fazën e vlerësimit dhe evidentimit të një forme të rregullit fiskal, por nuk mund të japin vlerësim për sjelljen e politikës fiskale në të ardhmen.

3. "EFEKTET MAKROEKONOMIKE TË POLITIKËS FISKALE NË SHQIPËRI; PËRQASJE ME SVAR"-NGA ARMELA MANÇELLARI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material studimi synon të vlerësojë efektin e politikës fiskale në ekonominë

shqiptare. Pyetja kryesore që ngre ky material është vlerësimi i multiplikatorit të PBB-së i politikës fiskale. Studimi trajton veç e veç dy llojet e politikës fiskale; uljen e taksave dhe rritjen e shpenzimeve. Metoda e vlerësimit është me model SVAR– Vektor Strukturorë Autoregresivë. Për identifikimin e goditjeve të pastra fiskale shfrytëzohet informacioni i mëposhtëm: së pari, përdorimi i të dhënave tremujore, bën që të mos vihen re reagime të njëkohëshme të politikës fiskale ndaj ndryshimeve në PBB, apo në indikatorë të tjerë ekonomikë sepse vendimmarrja dhe implementimi i ndryshimeve në politikën fiskale, kërkon më shumë se 1 tremujor. Së dyti, me anë të regresioneve lineare të MZKV-së, llogarisim elasticitetet e të ardhurave nga taksat, e transfertave dhe shpenzimeve kapitale ndaj PBB-së, e inflacionit dhe normave të interesit. Elasticitetet e llogaritura përfaqësojnë stabilizatorët automatikë, të cilët janë përgjigjet e njëkohëshme të politikës fiskale ndaj ndryshimeve makroekonomike. Rezultatet paraprake flasin për një shpjegim neoklasik të politikës fiskale në rastin e Shqipërisë.

4. "A KA NJË EFEKT ZËVENDËSUES TË HUAMARRJES SË BRENDSHME PUBLIKE NË ECURINË E INVESTIMEVE PRIVATE? - NGA BLENDAR HODA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Perspektiva neoklasike pretendon se rritja e investimeve publike tenton të ndikojë në zhvendosjen e investimeve private, nëpërmjet angazhimit të burimeve financiare të ekonomisë, rritjes së normave të interesit dhe angazhimit të faktorëve të prodhimit, me anë të konkurrencës së çmimit. Objekti i materialit fokusohet vetëm në efektin e borxhit të brendshëm

publik në ecurinë e investimeve private. Efekti zëvendësues i borxhit të brendshëm, në ecurinë e investimeve private, do të konfirmohej nëpërmjet pranisë së një marrëdhënieje afatgjatë midis këtyre dy treguesve dhe axhustimit të investimeve private kundrejt një rritjeje të borxhit publik.

5. "FAKTORËT KRYESORË MAKROEKONOMIKË NË PËRCAKTIMIN E RREZIKUT TË KREDISË: RASTI I SHQIPËRISË" - NGA IRI NI KALLUCI DHE ORIELA KODRA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material synon të studiojë lidhjen midis faktorëve të ndryshëm makroekonomikë dhe treguesve të rrezikut të kredisë, gjatë periudhës 2002-2009. Vlerësimi i marrëdhënies mes këtyre treguesve është i rëndësishëm në vendimmarrjen e politikave makroekonomike.

6. "VLERËSIMI I EFEKTIT AFATGJATË TË TURIZMIT NË RITJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË" - NGA JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky studim synon të masë efektin e sektorit të turizmit në rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit tonë, gjatë periudhës 1995-2008. Nëpërmjet analizës së fluksit të vizitorëve të huaj dhe të ardhurave totale reale në ekonomi, është studiuar lidhja afatgjatë e turizmit me rritjen ekonomike.

7. "STRESS-TESTING MBI RISKUN INDIREKT TË KREDITIT NË SHQIPËRI, BAZUAR NË KARAKTERISTIKAT E BANKËS" - NGA KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE HILDA SHIJAKU (DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR)

Materiali studion reagimin e raportit të kredive me probleme ndaj kushteve makroekonomike që përkeqësojnë aftësinë paguese të huamarrësve. Ky ndikim vihet re nëpërmjet kanaleve të rrezikut të kredisë, sipas karakteristikave të bankave si: madhësia, pronësia, kapitalizimi dhe tipare të tjera të portofolit të kredisë. Empirikisht, modeli është mundësuar me vlerësimin e të dhënave panel të bankave në Shqipëri dhe do të paraqitet me vlerë të shtuar në vlerësimin e parametrave që përdoren për stress-testing e bankave individuale.

8 "PËRCAKTUESIT E REMITANCAVE NË SHQIPËRI"-NGA ESIDA ABAZAJ, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material studimor synon të studiojë sjelljen e dërgesave të emigrantëve në Shqipëri, gjatë periudhës 1996-2009. Fokusi kryesor i këtij materiali është vlerësimi në mënyrë empirike i përcaktuesve të remitancave në nivelin makro, dhe të analizojë ndikimin e tyre, në situatën ekonomike të familjeve të emigrantëve dhe në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Njohja me përcaktuesit e remitancave dhe me ndikimin e tyre në ekonomi është e rëndësishme në hartimin e politikave të duhura makroekonomike, për tërheqjen e këtij burimi të rëndësishëm financimi.

IV. ARTIKUJ

Artikujt e përgatitur gjatë kësaj periudhe janë si më poshtë:

“INDEKSET E KUSHTEVE MONETARE DHE FINANCIARE: RASTI I SHQIPËRISË”, NGA ORIELA KODRA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material i bazuar në vlerësimet me MZKV, vlerëson IKM-në (indeksi i kushteve monetare) dhe IKF-në (indeksi i kushteve financiare) për rastin e Shqipërisë, si dhe vëzhgon ecurinë e tyre për periudhën janar 1996 – prill 2010. Bazuar në ecurinë e IKM-së, fillimi i krizës financiare karakterizohet nga kushte monetare të shtrënguara, kryesisht për shkak të rritjes së normës reale të interesit të bonove të thesarit. Në muajt e parë të vitit 2010, shohim që pas një periudhe të karakterizuar nga kushte monetare të përmirësuar, duke filluar nga muaji mars, ky indeks shpreh një shtrëngim të kushteve monetare. Ky përkeqësim vjen si efekt i rritjes të mëtejshme të normave të interesit të bonove të thesarit në terma reale, ndërkohë që monedha vendase vazhdon të karakterizohet nga një zhvlerësim i mëtejshëm. Ashtu si IKM-ja, edhe IKF-ja tregon që aktiviteti financiar karakterizohet nga kushte të shtrënguara për shkak të rritjes së normave reale të kredive. Vetëm pas mesit të vitit 2009, kushtet financiare fillojnë të përmirësohen si rrjedhojë e nënçmimit të lekut dhe e rënies së normave reale të kredive.

“PËRCAKTUESIT E RITJES EKONOMIKE NË SHQIPËRI”, NGA VASILIKA KOTA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material paraqet një analizë të burimeve të rritjes ekonomike në Shqipëri, pas periudhës së tranzicionit. Vlerësimi i përcaktuesve themelorë të rritjes ekonomike është i rëndësishëm për të kuptuar rolin që kanë luajtur në të kaluarën dhe si mund të jetë perspektiva e zhvillimit të tyre në të ardhmen. Krahasuar me vende të tjera të Evropës Qendrore apo Lindore, rritja ekonomike në Shqipëri pas viteve '90 është më e lartë se në shumicën e tyre. Sipas këtij materiali, burim kryesor i rritjes ekonomike në Shqipëri ka qenë përmirësimi i TFP-së, ndërkohë që pas vitit 2000, një rol të rëndësishëm ka luajtur stoku i kapitalit. Rrjedhimisht, meqenëse pas tranzicionit rritja e TFP-së e shkatuar nga riorganizimi i ekonomisë do të vijë gradualisht drejt zvogëlimit dhe zhvillimet në normën e rritjes së investimeve kanë treguar luhatje nga viti në vit, është e rëndësishme që Shqipëria të krijojë burime alternative të rritjes ekonomike. Në këto kushte, akumulimi i kapitalit përmes stimulimit të investimeve, merr një rëndësi të veçantë. Po aq e rëndësishme është të krijohen edhe përmirësime të tjera të TFP-së nga burime alternative, siç mund të jetë: përfitimi nga njohuritë teknologjike, rritja e eficiencën sipërmarrëse gjatë kohës, etj. . Së fundi, për shkak të konvertimit të sektorëve drejt rritjes së produktivitetit të punës në Shqipëri, është e rëndësishme të përmirësohet cilësia e këtij faktori prodhimi.

V. TË NDRYSHME

TRYEZA SHKENCORE: "RRITJA EKONOMIKE NË SHQIPËRI- NEVOJA PËR NJË MODEL TË RI"

Më 3 maj 2010, Instituti i Kërkimeve Ekonomike dhe Bankare i Bankës së Shqipërisë në Berat, organizoi tryezën shkencore me temë "Rritja ekonomike në Shqipëri-Nevoja për një model të ri", me pjesëmarrje të gjerë nga institucionet akademike dhe ndërkombëtare ku përmendim Bankën Botërore, FMN-në, USAID-in; dhe sigurisht me pjesëmarrjen e punonjësve të Bankës së Shqipërisë.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte nxitja e diskutimit produktiv shkencor mbi modelin aktual të rritjes ekonomike, faktorët kryesorë që kanë përcaktuar rritjen aktuale ekonomike, si dhe elementët kryesorë mbi të cilët do të mbështetet rritja ekonomike në të ardhmen. Këtu mund të përmendim: rritjen e konkurrueshmërisë, teknologjinë, investimet e huaja, turizmin, bujqësinë, rolin e emigracionit si edhe mjaft faktorë të tjerë.

Aktiviteti u organizua në tre seksione. Seksioni i parë u fokusua në studime dhe reflektime të modelit aktual të rritjes ekonomike në Shqipëri. Disa nga çështjet kryesore që u diskutuan, kishin të bënin me rolin e faktorëve të prodhimit dhe ndikimin e tyre në modelin aktual të rritjes ekonomike, me konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare; si dhe krahasimi rajonal i konkurrueshmërisë në tërheqjen e IHD-së (investimeve të huaja direkte) dhe rritjes së eksporteve, etj. . Disa nga konkluzionet më të rëndësishme të paraqitura gjatë këtij seksioni ishin:

- Investimet janë faktori kryesor në rritjen e stokut të kapitalit dhe japin kontributin më të madh në rritjen ekonomike;
- Rritja e produktivitetit total të faktorëve po ngadalësohet, prandaj duhen kërkuar burime të reja rritjeje;
- Niveli i konkurrueshmërisë së ekonomisë sonë, bazuar në raportet e ndërkombëtarëve, mbetet në nivele të ulëta, kështu që rritja e aftësive konkurruese të ekonomisë shqiptare përbën një sfidë të madhe në të ardhmen;
- Nevojë e menjëhershme për rritjen cilësore të kapaciteteve njerëzore, edukim profesional, trajnime për përdorimin e teknologjive të reja dhe investim në R&D.

Prezantues në këtë seksion ishin Vasilika Kota (Departamenti i Kërkimeve, BSH), Kasem Seferi (Këshilltar ekonomik në Presidencë), Dr. Erion Luçi (ekspert, Banka Botërore) dhe Prof. Dr. Ahmet Mançellari (Fakulteti i Ekonomisë, UT).

Në fund të seksionit, Dr. Bahri Musabelliu (Dekan i Fakultetit Bujqësor) diskutoi mbi gjendjen aktuale të bujqësisë në vendin tonë, duke nënvizuar se ky sektor përdor vetëm 50 % të kapacitetit të tij. Një rritje e mëtejshme e kapacitetit të këtij sektori do të sillte rritje të produktivitetit kryesisht në mbështetje të agro-biznesit.

Në seksionin e dytë, diskutimi u përqëndrua kryesisht mbi tregun e kapitalit dhe ndikimin e tij në rritjen ekonomike në të ardhmen. Prezantuesit

e këtij seksioni, Prof. Dr. Salvatore Messina (Universiteti Evropian i Turizmit), Jonel Kristo (Departamenti i Kërkimeve, BSH), Armela Mançellari (Departamenti i Kërkimeve, BSH), Prof. Dr. Agim Kukeli (Universiteti Aleksandër Mojsiu) dhe Dr. Ilir Gëdeshi (Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale), u fokusuan në çështje që kishin të bënin me rolin e IHD-ve, të dërgesave të emigrantëve dhe në ndikimin e turizmit si elementët bazë për zhvillimin e mëtejshëm të vendit dhe rritjes ekonomike. Disa nga konkluzionet e këtij seksioni janë si më poshtë:

- Tërheqja e IHD-ve kërkon fuqi të kualifikuar punëtore.
- Turizmi përbën një ndër avantazhet kryesore konkurruese të ekonomisë shqiptare, por zhvillimi i mëtejshëm i tij duhet të jetë në përputhje me mbrojtjen e mjedisit dhe me një administrim më të mirë në porte dhe aeroporte, bazuar në një marketing të fortë e duke siguruar standarde dhe cilësi.
- Të ardhurat e emigrantëve kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë, duke u përdorur kryesisht për konsum, por ato nuk kanë ndikuar në zhvillimin e vendit. Duhet të jetë detyrë e bankave të nivelit të dytë, promovimi i produkteve financiare që bëjnë të mundur tërheqjen e të ardhurave të emigrantëve, kryesisht në formën e investimeve.

Seksioni i tretë dhe i fundit u përqendrua në rolin e bujqësisë dhe teknologjisë në modelin e ri të rritjes, duke i kushtuar vëmendje edhe eksternaliteteve negative mjedisore të rritjes ekonomike. Prezantues në këtë sesion ishin Prof. Dr. Skënder Sala

dhe Prof. Dr. Perikli Qiriazhi (Universiteti i Tiranës), Prof. Asst. Dr. Adrian Shehu (Universiteti Politeknik i Tiranës) dhe Juan M. Estrada-Valle (USAID, Albanian Agriculture Competitiveness), të cilët konkluduan se:

- Rritja ekonomike e dy dekadave të fundit ka sjellë efekte negative në faktorët e prodhimit, sidomos në erozionin e tokës dhe keqpërdorimin e burimeve të tjera. Një menaxhim shkencor i trashëgimisë natyrore, nënkupton, përdorim harmonik të burimeve natyrore dhe sigurim të vazhdimësisë së tyre, si dhe mbrojtje me çdo kusht të vlerave natyrore.
- Teknologjia është një ndër faktorët primarë në zgjedhjen e modeleve të reja të zhvillimit ekonomik. Në ditët tona, teknologjia bën të mundur ndryshimin e stilit të jetesës së gjithsecilit, duke qenë një përcaktuese dhe mbështetëse e rëndësishme të zhvillimit ekonomik.

Në përfundim, tryeza shkencore nxori në pah mungesën e strategjive të mirpërcaktuara për një model të ri rritjeje. Debati për modelin e ri të rritjes ekonomike do të vazhdojë në seri të tjera të këtij aktiviteti, me grupe të tjera të interesit, duke synuar që diskutimet e mendimet të kthehen në rekomandime konkrete, me përzgjedhjen e disa prioriteteve kryesore për të ardhmen e modelit ekonomik shqiptar.

MODELET SATELITORE

Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve është objektivi kryesor i politikës monetare

së Bankës së Shqipërisë. Për shkak të rolit të rëndësishëm që luan inflacioni në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, mbajtja e tij nën kontroll është kontributi më i mirë që banka qendrore mund të japë për mbështetjen e rritjes ekonomike. Për arritjen e objektivit të saj, BSH përdor disa instrumente të politikës monetare, por efekti i tyre ndjehet me vonesa kohore në ekonomi dhe në inflacion. Për këtë arsye, është e rëndësishme që vendimmarrësit e politikës monetare të kenë njohuri mbi ecurinë e pritshme, jo vetëm të inflacionit si objektivi kryesor, por edhe të variablave të tjerë makroekonomike për shkak të ndërvarësisë së tyre në ekonomi.

Parashikimi i variablave kryesore makroekonomike për 12 muaj në avancë, ka marrë një rëndësi të veçantë në Bankën e Shqipërisë. Që nga fillimi i vitit 2009, Departamenti i Kërkimeve është angazhuar në ndërtimin e modeleve parashikuese, që njëkohësisht, shërbejnë edhe si modele satelitore të Modelit Makroekonomik të Shqipërisë MEAM. MEAM është përdorur jo vetëm për të projektuar të ardhmen, por edhe për të parë rezultatin tërësor të parashikimeve të veçanta për variablat ekonomikë, të integruar në një projektion të vetëm të ndërvarur. Modelet satelitore janë ekuacione univariate (me një variabël) dhe multivariate (me shumë variabla), që shërbejnë për parashikimin e variablave të tillë si: rritja ekonomike, ecuria e ndërmjetësimit financiar, normat e interesit, kursi i këmbimit, inflacioni, bilanci tregtar, etj. . Gjithashtu, për çdo model është llogaritur edhe cilësia e parashikimit me anë të disa treguesve ku përmendim: gabimin mesatar, gabimin mesatar absolut, rrënja mesatare e katrorit të gabimit etj. . Bazuar në analizën e plotë të gabimit të parashikimit për periudhën

2009-2010, cilësia e parashikimeve ka qenë e kënaqshme. Kjo konfirmon edhe saktësinë dhe cilësinë e parashikimit.

SEMINARET TEKNIKE

Një tjetër aktivitet që zhvillohet nga Departamenti i Kërkimeve, në kuadër të Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, është seminari teknik që organizohet një herë në dy muaj. Ky seminar ka si objekt prezantimin e të rejave më të fundit shkencore në fushën e ekonomisë, zhvillimin e metodave të reja të zgjidhjes së problemeve të ndryshme, modeleve origjinale matematikore të proceseve dhe fenomeneve, si dhe njohjen me rezultatet e marra nga përdorimi i tyre etj. . Gjatë periudhës janar- qershor të vitit 2010, janë organizuar tre prezantime të cilat kanë trajtuar këto tema:

1. Modelet ekonometrike ARDL.
2. Vlerësimi i gabimeve të parashikimit.
3. Simulimi Monte-Carlo -Parime dhe metoda.

Materiali me temë: “Specifikimi i modelit ARDL” u prezantua nga Altin Tanku, Departamenti i Kërkimeve. Ky model analizon empirikisht marrëdhënien afatgjatë dhe dinamikat afatshkurtra midis variablave që vlerësohen duke përdorur testet kufi (bound) në procedurën kointegruese, të zhvilluar nga Pesaran dhe Shin në vitin 2001. Avantazhet e përdorimit të kësaj metode janë: Së pari, procedura e testit kufi (bounds) janë të thjeshta dhe, ndryshe nga teknikat e tjera kointegruese si ajo e Johansen dhe Juselius, marrëdhënja afatgjatë vlerësohet

me anë të MZKV-së, ndërkohë që renditja e vonesës kohore është identifikuar. Së dyti, kjo metodë aplikohet pavarësisht nëse variablat në model janë vetëm $I(0)$, vetëm $I(1)$ ose $I(0)$ dhe $I(1)$. Së treti, kjo procedurë është më efiçente në një kampion me pak të dhëna.

Tema “Vlerësimi i gabimeve të parashikimit” u prezantua nga Vasilika Kota, Departamenti i Kërkimeve. Dihet që parashikimet e variablave ekonomike kanë marrë një rëndësi të veçantë në bankat qendrore, por parashikimi i të ardhmes, është gjithmonë i vështirë dhe përfshin pasiguri. Për këtë arsye, është e nevojshme që paralel me procesin e parashikimit, të sinkronizohet edhe procesi i studimit të gabimeve të parashikimit. Kështu, disa nga treguesit kryesorë që përdoren në literaturë për matjen e gabimit janë:

- Gabimi mesatar (ME), i cili shërben për vlerësimin e devijimeve të vlerave të parashikuara ndaj atyre aktualeve, duke përcaktuar nëse ka anshmëri (bias) në parashikim.
- Gabimi mesatar absolut (MAE), i cili vlerëson masën e gabimeve të parashikimit.
- Rrënja e mesatares së katrorit të gabimit (RMSE) është një tregues, i cili vlerëson se gabimet në vlerë të madhe janë më keq se gabimet në vlerë të vogël.
- Gabimi mesatar në përqindje (MPE), i cili tregon ç’peshë zë gabimi i parashikimit në vlerën aktuale të treguesit.
- Gabimi absolut mesatar në përqindje (MAPE), i cili është një tregues krahasimi që nuk përfshin problemin e mesatarizimit të gabimeve pozitive dhe negative.

Përveç vlerësimit të saktësisë së parashikimit, është e nevojshme të vlerësojmë dhe aftësinë e modeleve për të parashikuar kahun e lëvizjes, pra nëse do të ketë rënie apo rritje të treguesve për çdo periudhë parashikimi. Statistika e përdorur llogarit përqindjen e rasteve të gjetjes së kahut të lëvizjes nga modeli i parashikimit, në raport me kahun e realizuar nga vlerat aktuale.

Një tjetër prezantim ishte ai me temë “Simulimi i ndryshoreve të rastit, parime dhe metoda” që u mbajt nga Kliti Ceca, Departamenti i Kërkimeve. Ky prezantim trajtoi simulimin Monte-Carlo, gjenerimin e ndryshores $f \sim U(0,1)$, modelimin e një ndryshoreje të rastit, metodat e përgjithshme, etj. . Me gjenerim të një ndryshoreje rasti me një shpërndarje të dhënë probabilitare, do të kuptojmë gjetjen e metodave matematikore për formimin e një bashkësie numrash reale, për të cilën pranohet hipoteza statistike e shpërndarjes probabilitare të ndryshores së rastit të dhënë. Studimi i metodave të gjenerimit të ndryshoreve të rastit ka rëndësinë e tij teorike sepse lejon të shihet se si mund të merret një ligj i çfarëdoshëm, i dhënë për një shpërndarjeje probabilitare nëpërmjet ligjit uniform. Këto metoda gjejnë një përdorim të gjerë nga ana praktike, si për zgjidhjen e problemeve reale, ashtu edhe për problemet deterministe siç është për shembull llogaritja e numrit π . Krahasuar me metodat numerike, metodat e gjenerimit të ndryshoreve të rastit dallohen për thjeshtësinë e algoritmeve të ndërthuara.

LINQE:**PUNË KËRKIMORE TË BANKAVE TË TJERA QENDRORE**

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Deutsche Bundesbank (http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php)

Oesterreichische Nationalbank (http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp)

Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of Finland (http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm)

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

TË TJERA

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.

Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569.

Faks: 355-4-2223558.

E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 600 kopje.

Shtypur në shtypshkronjën AdelPrint.